

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

**Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë**

**Qershor 2014**

## **PËRMBAJTJA**

LISTA E SHKURTESAVE .....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	4
HYRJE .....	5
1. MJEDISI MEDIATIK, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANET QË NDËRLIDHEN ME MEDIAT .....	7
<b>1.1. Mjedisi mediatik</b> .....	7
<b>1.2. Korniza ligjore dhe organet që ndërlidhen me mediat</b> .....	8
2. SFIDAT LIDHUR ME SHKELJET E LIRISË SË MEDIAVE DHE SIGURISË SË GAZETARËVE .....	11
<b>2.1. Frikësimet, kërcënimet dhe ushtrimi i dhunës ndaj gazetarëve</b> .....	12
<b>2.2. Trysnia financiare mbi mediat dhe gazetarët</b> .....	13
<b>2.3. Ndikimi i biznesit privat tek gazetarët</b> .....	15
PËRFUNDIME .....	17
REKOMANDIME .....	18

## **LISTA E SHKURTESAVE**

BSPK	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
AMPEK	Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës
AGPK	Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
INDEP	Instituti për Politika Zhvillimore
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IMK	Instituti i Medias i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KTV	Kohavision
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë
KMSHK	Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
RPK	Reporterët pa kufi
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
RTV21	Radio Televizioni 21
UGK	Unioni i Gazetarëve të Kosovës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjendja e përgjithshme përkitazi me lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në Kosovë është temë debati dhe është analizuar në disa raporte të hartuara nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore. Gjetjet e paraqitura në këtë hulumtim mbështesin mendimin e pranuar botërisht se gjendja mbetet e ndjeshme përkundër disa përmirësimeve.

Ekziston nivel i caktuar i konsistencës në lidhje me sfidat e paraqitura në këto raporte. Sfidat kryesore për lirinë e medias që u përsëritën gjatë pesë viteve të fundit në Kosovë kanë të bëjnë kryesisht me sundimin e ligjit. Legjislacioni kyç është miratuar apo ndryshuar në vitet e fundit por problem mbetet zbatimi i tij. Ekzistojnë raporte se gazetarët janë kërcënuar, frikësuar, se është ushtruar trysni ndaj tyre dhe se në disa raste janë sulmuar fizikisht. Gjyqësori deri më tani ka qenë i ngathët në trajtimin e rasteve të tilla. Ligji i punës gjithashtu nuk zbatohet në masë të mjaftueshme, posaçërisht në sektorin privat që përfaqëson shumicën e skenës mediatike ku pasiguria e vendit të punës ndër gazetarë paraqitet si një sfidë shtesë.

Disa media fillimisht u zhvilluan përmes ndihmës së donatorëve, por jo të gjitha prej tyre janë në vijë me nevojat e tregut. Raporti i shpenzimeve qeveritare në reklama *kundrejt* të ardhurave nga sektori privat anon në dobi të së parës, duke nxitur kështu pohimet e herëpashershme të ndikimit politik të pavend që ushtrohet mbi mediat përmes fondeve të reklamave. Pagat në sektor nuk janë konkurruese dhe ndërrimi i shpeshtë i punëtorëve paraqet një sfidë për punëdhënësit.

Sa i përket organizimit të brendshëm të gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë në media, shumë prej tyre janë të organizuar në mënyrë të papenguar në dy asociacione relativisht aktive. Pretendimet e besueshmërisë së pamjaftueshme janë gjithashtu relativisht të theksuara. Nuk ekziston ndonjë sindikatë që do të përfaqësonte sektorin e medias në përgjithësi apo gazetarët në veçanti, me përjashtim të dy sindikatave që mëtojnë të përfaqësojnë interesat e punonjësve të transmetuesit publik. Prandaj, nuk është e pazakonshme për gazetarët dhe mediat që të kërcënohen me padi, ndërsa shumë raste përfundojnë në gjykata.

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes, përqendrimi i të gjithë aktorëve kryesorë duhet të ndryshojë nga legjislacioni në instrumentet përgjegjëse për zbatimin e tij. Procedurat, sipas së cilave qeveria dhe kompanitë në pronësi publike shfrytëzojnë buxhetin për reklama, duhet të bëhen tërësisht transparente dhe duhet t'i përgjigjen numrit të lexuesve dhe tirazhit për cilindo medium që pranon fonde për reklama nga sektori publik. Komuniteti i donatorëve po ashtu duhet t'i rishikojë politikat e veta, duke shtuar kështu përkrahjen për sektorin e medias dhe duke siguruar një proces transparent dhe konkurrues në shpërndarjen e fondeve të veta. Shoqëria civile dhe vetë mediat duhet të bëjnë përpjekje për të shtuar besueshmërinë e sektorit të medias, duke rritur kontrollin ndaj punës gazetareske dhe duke shtyrë përpara projektet që rrisin nivelin e profesionalizmit.

## HYRJE

Në këtë raport vlerësohet liria e mediave, zbatimi i kornizës ligjore të zbatueshme që siguron lirinë e shprehjes dhe të medias, qasjen në informacion, mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, standardet e raportimit profesional dhe nivelin e vetë-censurimit/censurimit në media, si dhe frikësimin dhe kërcënimet ndaj gazetarëve. Në raport gjithashtu vlerësohet puna e institucioneve të medias në mbrojtjen e lirisë së medias.

Raporti e bazon përkufizimin e vet të lirisë së medias në nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (OKB) që përcakton se liria e mendimit dhe e shprehjes përfshin “lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.”<sup>1</sup> Ky përkufizim vlen edhe për lirinë e medias, shprehje që përdoret në këtë raport edhe për lirinë e shtypit. Në këtë raport përkufizimit të lirisë së shtypit ia kemi shtuar përkufizimin e mbrojtjes nga institucionet e përgjithshme e aktorët tjerë që nuk i përkasin medias. Si e tillë, pavarësia e mediave gjithashtu përfshin mungesën e trysnisë së drejtpërdrejtë a të tërthortë nga autoritetet apo ndonjë aktor tjetër përmes kontrollit financiar, frikësimit, dhunës dhe metodave tjera shtrënguese ndaj medias.

Në vlerësimin e asaj që u cek më sipër, u parashtruan dy pyetje të përgjithshme hulumtuese. Së pari, hulumtimi shqyrtoi se cilat sfida dhe shkelje të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve ishin të pranishme në Kosovë. Së dyti, hulumtimi studion reagimin ndaj shkeljeve dhe sfidave ndaj lirisë së shprehjes dhe të medias dhe sigurisë së gazetarëve.

Në vlerësimin e këtyre pyetjeve u përdor një qasje metodologjike e ndarë në dy faza. Faza e parë përbëhej nga rishikimi sistematik i literaturës ekzistuese për mediat në Kosovë për periudhën pesëvjeçare deri në maj të vitit 2013. Faza e parë përfshiu analizën e burimeve parësore dhe dytësore. Për burimet parësore u përdorën dy kritere për përzgjedhjen e literaturës: qëndrueshmëria e botimit të studimeve që mundëson vlerësimin krahasimtar vit pas viti dhe besueshmëria e metodologjisë. Për shkak të numrit të vogël të studimeve për skenën mediatike në Kosovë, u vlerësuan të gjitha materialet që i përmbaheshin të dy kritereve. Lista përfundimtare e raporteve të përzgjedhura është: Freedom House Shtetet në Tranzicion, Reporterët pa Kufij, Indeksi i Lirisë së Medias, Raportet e Progresit të Komisionit Evropian, Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias i IREX-it dhe Instituti për Politika Zhvillimore (IPZH).

Të dhënat nga hulumtimi parësor u sintetizuan sipas metodave të rishikimit sistematik realist me qëllim të vlerësimit të problemeve ekzistuese sipas këtyre raporteve, zgjidhjet e propozuara sipas disponueshmërisë, efikasitetit dhe miratimit të këtyre zgjidhjeve në baza vjetore, ajo çka ka funksionuar dhe çka nuk ka funksionuar në zgjidhjen e sfidave dhe në çfarë konteksti. Burimet dytësore të hulumtimit u përzgjedhën në bazë të disponueshmërisë për shkak të mungesës së burimeve të dhënave, kryesisht si mjete për të dhënë përgjigje në pyetjen e dytë hulumtuese të këtij studimi. Këto burime ishin: të dhënat statistikore zyrtare të frikësimit dhe kërcënimeve ndaj mediave dhe gazetarëve nga Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovë (AGPK), të

---

<sup>1</sup> Neni 19 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, <http://www.un.org/en/documents/udhr/index.shtml#a19> (qasur më 12 mars 2014)

dhënat e ndjekjes penale nga Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) dhe reagimet zyrtare të institucioneve të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare që punojnë në Kosovë ndaj shkeljeve të lirisë së medias. Në mënyrë të ngjashme, metodat e rishikimit sistematik realist u përdorën për t'i vlerësuar këto të dhëna.

Hulumtimi i fazës së parë identifikoi një hendek në qasjen drejt trajtimit të qëllimit të këtij studimi dhe pyetjeve të hulumtimit. Ky hendek përbëhej nga mungesa e perceptimit, qëndrimit dhe informacionit për pozitën e profesionistëve të medias në Kosovë për çështjet që ky studim mëtonte t'i trajtonte. Si pasojë e kësaj, faza e dytë e këtij hulumtimi kishte si qëllim vlerësimin e perceptimeve dhe pasqyrimeve të profesionistëve të medias në Kosovë përmes dy mënyrave kryesore: fokus grupet dhe intervistat e drejtpërdrejta gjysmë të strukturuar. Fokus grupi u organizua për të analizuar perceptimet individuale, argumentet e forta të mendimeve, marrëveshjet e përgjithshme të grupit dhe botëkuptimet e ndara në mënyrë kolektive. Pyetjet për intervistën me fokus grupet ishin të përgatitura, por moderatorët e tyre lejuan diskutim më të gjerë. Intervistat e drejtpërdrejta gjysmë të strukturuar me profesionistët e medias u zhvilluan me qëllim të vlerësimit të hendekut të lartcekur si dhe të gjetjeve të fazës së parë të raportit.

# 1. MJEDISI MEDIATIK, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANET QË NDËRLIDHEN ME MEDIAT

## 1.1.Mjedisi mediatik

Aktualisht janë shtatë gazeta të përditshme në Kosovë: Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot, Bota Sot, Tribuna, Lajm, Epoka e Re. Një gazetë tjetër, Gazeta Express, kaloi nga versioni i shtypur në atë elektronik në vitin 2013. Nuk ka informata të pavarura për numrin e saktë të tirazhit të shitur ndërsa shifrat e gazetave janë zakonisht të fryra për të dëshmuar një hisë më të madhe në tregun e reklamave.

Numri i gazetave të përditshme është dukshëm më i vogël sesa numri i përgjithshëm i transmetuesve. Tani për tani, numri i transmetuesve të licencuar në Kosovë është 167, ku 21 janë stacione televizive, 83 janë radio stacione, 14 janë operatorë kabllorë dhe 49 janë ofrues të shërbimeve të programeve që operojnë përmes operatorëve të shërbimeve kabllorë.<sup>2</sup> Aktualisht nuk ka ndonjë regjistër a të dhëna statistikore zyrtare përkitazi me numrin e përgjithshëm të mediave të shkruara në Kosovë, përveç shtatë gazetave të përditshme.

Nga 21 stacione televizive, tre kanë mbulim në mbarë Kosovën: transmetuesi publik, Radio Televizioni i Kosovës, dhe transmetuesit në pronësi private– Radio Televizioni 21 (RTV21) dhe Kohavision (KTV). Me një audiencë të kufizuar – më pak se 1.8 milion njerëz në përgjithësi<sup>3</sup> - tregu i reklamave është mjaft i vogël duke e bërë kështu skenën mediatike të paqëndrueshme në kuptimin financiar. Mediat janë kryesisht të financuara përmes reklamave, me kontribute të vogla që vijnë nga shitja e gazetave në rast të mediave të shkruara. Nuk ka të dhëna statistikore zyrtare për madhësinë e vërtetë të tregut të reklamave në Kosovë. Shifrat për tirazhin e gazetave raportohen nga vetë gazetatat dhe nuk ka ndonjë burim të tretë të pavarur për vërtetimin e tyre.

Transparenca rreth pronësisë së medias në Kosovë ende mbetet një sfidë, ndonëse pronarët e mediave janë kryesisht të njohur. Mediat në pronësi private janë të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë<sup>4</sup> dhe pronarët janë të cekur me emër. Pronarët njihen kryesisht për shkak të tregut të vogël në përgjithësi dhe si rezultat i ndërveprimit social.

Ajo çka u cek më sipër nuk zbatohet për mediat elektronike (*online*). Aktualisht kryesisht të parregulluara dhe pa regjistrim të duhur, pronësia, financat dhe burimet njerëzore në tregun e mediave elektronike janë pothuajse tërësisht të panjohura.

---

<sup>2</sup> Komisioni i Pavarur për Media, Kosovë, raporti vjetor i punës për vitin 2012, Prishtinë/Priština, 2013, f.15 <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1369054659.2327.pdf> (qasur më 27 nëntor 2013).

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Kosovë, Vlerësim: popullsia e Kosovës 2012, Prishtinë/Priština, 2013, f.8, <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Estimation%20of%20Kosovo%20Population%202012.pdf> (qasur më 27 nëntor 2013).

<sup>4</sup> Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, <http://www.arbk.org/en/Home> (qasur më 30 nëntor 2013).

Vështirësitë financiare ndikojnë në pagat e gazetarëve që janë shumë jo konkurruese në krahasim me gjithë sektorin privat në Kosovë. Si pasojë e kësaj, mediat luftojnë me konkurrencën jo vetëm nga sektori privat por edhe nga ai publik. Kjo ka një ndikim të rëndësishëm në nivelin e profesionalizimit, ku shkalla e qarkullimit të gazetarëve mbetet e lartë dhe mundësitë për zhvillim mbeten të ulëta. Nuk ka të dhëna statistikore të veçanta për sektor për trendet në tregun e punës në Kosovë, por edhe siç e kanë cekur disa nga të intervistuarit, janë vetëm disa gazetarë të cilët kanë mbetur në këtë profesion vazhdimisht gjatë dhjetë viteve të fundit. Pagat e ulëta dhe siguria e punës shihen si arsye kryesore për shumë njerëz të cilët kalojnë në sektorë të ndryshëm, shpeshherë që nuk kanë të bëjnë me punën e gazetarëve.

## **1.2. Korniza ligjore dhe organet që ndërlidhen me mediat**

Korniza ligjore dhe organet që ndërlidhen me mediat mëtojnë të mbrojnë integritetin e gazetarëve dhe mediave nga ndërhyrja politike dhe interesat e pronësisë, duke kontribuar kështu në raportim të lirë, etik dhe profesional.<sup>5</sup> Sidoqoftë zbatimi me sukses i legjislacionit varet nga institucionet që kanë për detyrë zbatimin e ligjeve. Në Kosovë, institucionet e tilla si gjyqësori dhe policia kanë pak përvojë në trajtimin e rregullimeve moderne të mediave. Në anën tjetër organet rregulluese dhe vetë-rregulluese të medias, si Këshilli i Mediave të Shkruara (KMSH) dhe Komisioni i Pavarur për Media (KPM), kanë pak kapacitete për të zbatuar rregulloret e veta përkitazi me mediat.<sup>6</sup> Si pasojë, përkundër ekzistimit të mekanizmave dhe të legjislacionit për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në përgjithësi dhe gazetarëve në veçanti, shpeshherë mungon zbatimi efektiv i tyre.

Ligji për RTK-në, i miratuar në vitin 2012, i mundëson në parim transmetuesit publik që të mbrojnë pavarësinë e tij editoriale dhe llogaridhënien publike.<sup>7</sup> Megjithatë RTK-ja vazhdon që të financohet drejtpërdrejtë nga buxheti i Kosovës deri në vitin 2015. Prandaj ende ka shqetësime në lidhje me ndikimin politik.

Mediat transmetuese rregullohen nga KPM-ja – institucion i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Kosovës<sup>8</sup> - që është përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e frekuencave të transmetimit. KPM-ja është gjithashtu përgjegjëse për licencimin e transmetuesve, hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregulloreve për këta transmetues dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Për këtë qëllim, KPM-ja monitoron mediat transmetuese për shkeljet e rregulloreve dhe pranon ankesa nga palët e treta për shkeljet e tilla. Vlerësimi i këtyre ankesave bëhet nga Bordi i KPM-së që emërohet nga Kuvendi i Kosovës. Mediat e shkruara dhe portalet e tyre elektronike rregullojnë veten përmes KMSHK-së, një organ vetërregullues që zbaton Kodin për Mediat e Shtypura të Kosovës<sup>9</sup> dhe standardet etike, si dhe që funksionon sipas statutit të vet.<sup>10</sup> KMSH përbëhet nga

---

<sup>5</sup> Komisioni Evropian, Raport evropian i politikave, implikimet e politikave të MEDIADDEM, projekt i financuar nga BE-ja për politikën e mediave në 14 shtete për lirinë e medias dhe pavarësinë, qershor 2011, f.5. [http://ec.europa.eu/research/social-sciences/pdf/policy-briefs-mediadem\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/research/social-sciences/pdf/policy-briefs-mediadem_en.pdf) (qasur më 27 nëntor 2013).

<sup>6</sup> Qavdarbasha, Sh. "Gjendja e mediave në Kosovë 2012", Prishtinë/Priština, 2012.

<sup>7</sup> Ligji nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, 27 prill 2012.

<sup>8</sup> Ligji nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media, 5 prill 2012

<sup>9</sup> Kodi i Mediave të Shtypura të Kosovës, [http://presscouncil-ks.org/repository/docs/Press\\_Code\\_for\\_Kosovo-eng.pdf](http://presscouncil-ks.org/repository/docs/Press_Code_for_Kosovo-eng.pdf) (qasur më 25 mars 2014)



kryeredaktorët e mediave të shkruara apo përfaqësuesit e tyre dhe tre anëtarë të pavarur. Përkundër suksesit në trajtimin dhe shqyrtimin e të gjitha ankesave, KMSHK ka numër të pamjaftueshëm të punonjësve dhe përballet me probleme të vazhdueshme për sa i përket financimit.<sup>11</sup> Kjo dëmton aftësinë e KMSHK-së për ta informuar publikun.

Ligji i ri për KPM-në<sup>12</sup> ka marrë lëndë nga institucionet si Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare.<sup>13</sup> Mirëpo, rregullimi i transmetuesve bëhet kryesisht përmes akteve nënligjore që i ka nxjerrë KPM-ja dhe shumë pak është bërë për t'i përmirësuar dhe përditësuar ato.

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)<sup>14</sup> dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë e kanë mirëpritur miratimin e Ligjit për RTK-në. Sipas Zyrës, ky ligj vendos një bazë të mirë ligjore për të siguruar funksionimin e këtij institucioni në shërbim të interesit publik të Kosovës, pa rënë nën ndikimin e politikës dhe në përputhje me praktikatat më të mira të BE-së.

Në Kosovë janë aktive dy shoqata të gazetarëve, Unioni i Gazetarëve të Kosovës (UGK) dhe AGPK-ja. Që të dyja kanë rol të ngjashëm me njëra-tjetrën, që përfshin mes tjerash përfaqësimin e të drejtave të gazetarëve, kontributin në ngritjen e etikës dhe profesionalizmit në gazetari, dhe reagimin kundër kërcënimeve të ndryshme ndaj lirisë së medias apo integritetit të gazetarëve. Kuvendi i AGPK-së përbëhet nga gjithë anëtarët, që arrijnë një numër prej rreth 240 gazetarësh, dhe zgjedh anëtarët e organeve drejtuese nga anëtarësia e vet, ndërsa, për sa i përket anëtarësisë së UGK-së, nuk ka të dhëna të sakta.

Instituti i Medias i Kosovës (IMK) është organizatë që mëton të rritë shkallën e profesionalizmit të mediave. Sipas informacioneve në faqen e tyre të internetit, IMK është organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare, e menduar si qendër avokimi dhe trajnimi për sektorin e medias në Kosovë, dhe i themeluar sipas kërkesës së mediave, për t'iu shërbyer nevojave të tyre.

Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës (AMPEK) përfaqëson shumicën e mediave elektronike të Kosovës dhe bashkëpunon ngushtë me IMK-në. Veprimtaria e tyre është e ngjashme me atë të shoqatave të tjera, ndonëse aktualisht ata janë të stërngarkuar me çështje të lidhura me kalimin në platformë digjitale të rrjetit të transmetimit tokësor në Kosovë.

---

<sup>10</sup> KMSHK, "Statuti i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës" (Prishtinë/Priştina, 31 janar 2009) [http://www.presscouncil-ks.org/repository/docs/Statute\\_PCK\\_English\\_FINAL.pdf](http://www.presscouncil-ks.org/repository/docs/Statute_PCK_English_FINAL.pdf) (i qasur më 27 nëntor 2013)

<sup>11</sup> Nehat Islami, Kryesues, KMSHK, intervistë individuale, Prishtinë/Priştina, korrik 2013.

<sup>12</sup> Ligji nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, 5 prill 2012.

<sup>13</sup> Zyra e BE-së në Kosovë, "Zyra e BE-së në Kosovë mirëpret miratimin e Ligjit për RTK-në dhe të Ligjit për KPM-në." (Zyra e BE-së në Kosovë, 29 mars 2012) [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/press\\_corner/all\\_news/news/2012/29032012\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/press_corner/all_news/news/2012/29032012_en.htm) (qasur më 27 nëntor 2013)

<sup>14</sup> Misioni i OSBE-së në Kosovë mirëpret miratimin e legjislacionit të ri për transmetuesin publik (Prishtinë/Priştina, 13 prill 2012), <http://www.osce.org/kosovo/89689> (qasur më 25 mars 2014)

Nuk ka asnjë sindikatë kryesore që t'i përfaqësojë interesat e gjithmbarshme të gazetarëve në Kosovë. Në kuadër të RTK-së veprojnë dy sindikata të punonjësve, e që janë Sindikata e punëtorëve të RTK-së dhe Sindikata e Pavarur e RTK-së, ndërsa njëfarë përfaqësimi bëhet edhe përmes Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK). Megjithëkëtë, nuk ekziston asnjë institucion që do të punonte enkas dhe në mënyrë të organizuar për mbrojtjen e së drejtës në punë të gazetarëve dhe/ose profesionistëve të mediave në Kosovë.

Kuadri ligjor në Kosovë garanton lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, duke vënë themele të forta për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe lirive. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se garantohet edhe zbatimi i ligjeve dhe masave mbrojtëse të veçanta të parapara me këtë kuadër.

Sidoqoftë, është shënuar përparim për sa i përket miratimit të legjislacionit. Zhvillim më me rëndësi ka qenë de-penalizimi i shpifjes dhe fyerjes, dhe trajtimi i tij vetëm si çështje civile. Është miratuar Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes<sup>15</sup>, që rregullon përgjegjësitë civile për shpifje dhe fyerje. Ndryshe nga Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës,<sup>16</sup> që ka paraparë dënim me burg për veprat penale të shpifjes dhe fyerjes, Kodi i ri Penal i miratuar në vitin 2012<sup>17</sup> nuk përcaktonte vepra penale të këtilla. Veç kësaj, Kodi i ri i përmbante dy nene kundërthënëse: nenin 37 mbi përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të mediave (kryeredaktorët, botuesit, shtyp shkronjësit ose prodhuesit) dhe nenin 38 mbi mbrojtjen e burimit të informatës. Pas reagimit të ashpër dhe fushatës pasuese nga mediat, shoqëria civile dhe disa deputetë të Kuvendit të Kosovës, si dhe avokimit të përbashkët nga ana e palëve ndërkombëtare të interesit, dy nenet në fjalë u hoqën krejtësisht<sup>18</sup> nga Kodi Penal dhe më 1 gusht 2013 u miratua një Ligj i ri për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë<sup>19</sup>.

Ligji për qasje në dokumente publike është miratuar në vitin 2010.<sup>20</sup> Një studim i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) rreth zbatimit të këtij ligji gjatë gjithë vitit 2012<sup>21</sup> ka gjetur që të gjitha ministritë kanë caktuar zyrtarë me detyrën për t'i shqyrtuar kërkesat për qasje në dokumente publike. Krahasuar me vitet e shkuara, është shënuar përparim për sa i përket përgjigjes së institucioneve në kërkesat për qasje në dokumente publike, përkundër ankesave nga mediat dhe shoqëria civile rreth paqartësisë dhe rregullimit të pamjaftueshëm të procedurës vijuese në aktet nënligjore. Problemi i kamotshëm i lëndëve të grumbulluara ka ndikim të madh

<sup>15</sup> Ligji civil nr. 02/L-65 kundër shpifjes dhe fyerjes, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/13;

<sup>16</sup> Nenet 187 (Fyerja) dhe 188 (Shpifja), Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/25, 6 korrik 2003, me ndryshimet dhe plotësimet e më pastajme;

<sup>17</sup> Kodi penal nr. 04/L-082 i Kosovës, 13 korrik 2012, siç është ndryshuar dhe plotësuar më 9 nëntor 2012 me Ligjin nr. 04/L-129;

<sup>18</sup> Ligji nr. 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal nr. 04/L-082 të Kosovës, 9 nëntor 2012. Ky ligj ka për qëllim heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi Penal i Kosovës;

<sup>19</sup> Ligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Laë%20on%20the%20protection%20of%20the%20journalism%20sources.pdf> (qasur më 25-03-2014)

<sup>20</sup> Ligji për qasje në dokumente publike, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-215-alb.pdf> (qasur më 25-03-2014)

<sup>21</sup> Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese, "Shteti 30% i qasshëm për qytetarët," (Prishtinë/Priştina, 31 tetor 2013). [http://gazetajnk.com/repository/docs/Raporti\\_per\\_qasje\\_ne\\_dokumente\\_publike\\_final\\_40191\\_779858.pdf](http://gazetajnk.com/repository/docs/Raporti_per_qasje_ne_dokumente_publike_final_40191_779858.pdf) (qasur më 27 nëntor 2013)

në trajtimin nga ana e gjykatave të rasteve të mohimit të së drejtës për qasje në dokumente publike. Në korrik të vitit 2013, Zyra për Informim pranë Zyrës së Kryeministrit, në bashkëpunim me Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), ka publikuar një përmbledhje që përmban të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të lidhura me zbatimin e Ligjit për qasje në dokumente publike, e që është vlerësuar si hap i rëndësishëm drejt sqarimit të procedurave.<sup>22</sup>

Megjithatë, përkundër nxjerrjes së legjislacionit të ri, vazhdon të ketë probleme në zbatim dhe përbarim. Shpesh, gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë kanë më shumë sfida për ta interpretuar legjislacionin e nxjerrë rishtas. Gjithashtu, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK), që është përgjegjës për aftësimin e personelit të gjyqësorit, përballet me sfida serioze për ta mbajtur hapin me ndryshimet dhe plotësimet e vazhdueshme që pëson legjislacioni. Për shqyrtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me të drejtat e medias dhe lirinë e shprehjes kërkohen njohuri të specializuara, meqë gjatë procedimit të tyre gjithmonë duhet mbajtur parasysh baraspeshimin midis lirisë së shprehjes dhe të drejtave të tjera, siç janë e drejta për privatësi dhe integritet personal. Aktualisht, IGJK nuk ka asnjë program aftësimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve për t'i trajtuar rastet e këtilla.

## **2. SFIDAT LIDHUR ME SHKELJET E LIRISË SË MEDIAVE DHE SIGURISË SË GAZETARËVE**

Shqyrtimi i raporteve të përzgjedhura<sup>23</sup> ka shpalosur që gjendja e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve në pesë vitet e fundit nuk ka pësuar ndonjë ndryshim. Në raportet që bëjnë rangimin e vendeve, siç janë ato të Freedom House, IREX Media dhe RSF, Kosova vazhdon ta mbajë pak a shumë të njëjtën pozitë nëpër lista.<sup>24</sup> Freedom House vazhdon ta kategorizojë Kosovën si “pjesërisht të lirë”, ndërsa rangimi i RSF-së vazhdon të jetë gati-gati i njëjtë, me një ngritje të lehtë për pesë vende që nga viti 2012, një rimëkëmbje kjo qëkurse Kosova pati shënuar rënie të madhe në rangim në vitin 2010.<sup>25</sup> Që të dyja organizatat e sipërpërmendura reagojnë në disa raste në vitin 2012 në mbrojtje të lirisë së shprehjes dhe integritetit të gazetarëve në Kosovë, duke u bërë thirrje institucioneve që t'i hetojnë kërcënimet ndaj gazetarëve dhe duke i bërë apel Kuvendit të Kosovës që të del në mbrojtje të lirisë së shprehjes duke i rishikuar dispozitat e diskutueshme të ligjit përkatës.<sup>26</sup>

---

<sup>22</sup> Kajtazi, B. “Përmbledhje legjislacioni për të drejtën e qasjes në dokumente publike,” Prishtinë/Priština, 2012. Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/I\\_PERMBLEDHJE\\_LEGJISLACIONI\\_PER\\_TE\\_DREJTEN\\_E\\_QASJES\\_NE\\_DOKU.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/I_PERMBLEDHJE_LEGJISLACIONI_PER_TE_DREJTEN_E_QASJES_NE_DOKU.pdf)

<sup>23</sup> IREX, Indeksi i qëndrueshmërisë së mediave në Evropë & Euroazi (2002 – 2013). Freedom House, Liria e shtypit (2002 -2013). Freedom House, Kombet në tranzicion (2003-2013). Reporterët pa kufij, Indeksi botëror i lirisë së shtypit (2005-2014).

<sup>24</sup> Qavdarbasha, Sh. “Gjendja e mediave në Kosovë 2012”, Prishtinë/Priština, 2012

<sup>25</sup> Reporterët pa kufij, “Sulmet kundër zyrave të mediave,” 20 korrik 2012. <https://en.rsf.org/kosovo-attacks-on-media-offices-20-07-2012,43076.html> (qasur më 24 mars 2014).

<sup>26</sup> Freedom House, “Kuvendi i Kosovës të mbrojë lirinë e shprehjes gjatë rishikimit të Kodit Penal,” Uashington, 14 qershor 2012. [http://www.freedomhouse.org/article/kosovo%E2%80%99s-parliament-must-protect-freedom-expression-revising-criminal-code#.UzA5N\\_nxrVA](http://www.freedomhouse.org/article/kosovo%E2%80%99s-parliament-must-protect-freedom-expression-revising-criminal-code#.UzA5N_nxrVA) (qasur më 24 mars 2014).

Raportet e progresit të KE-së për Kosovën kanë pasur qëndrim shumë kritik ndaj lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve në periudhën prej 2009 deri 2012, duke konstatuar që liria e shprehjes nuk garantohej plotësisht, që kuadri përkatës institucional nuk është tërësisht funksional, dhe se institucionet e Kosovës duhet të marrin masa më rigorozë për trajtimin e rasteve të kërcënimeve politike.<sup>27</sup> Raportet e progresit për Kosovën të viteve të fundit vlerësojnë se Kosova ka shënuar përparim të kufizuar, duke vënë në dukje çështjen e pazgjidhur të financimit të qëndrueshëm të RTK-së dhe, për pasojë, pavarësisë së tij editoriale. Raportet kanë qëndrim edhe më kritik ndaj çështjeve të lidhura me trysinë që ushtrohet ndaj gazetarëve, duke përmendur ngritjen e aktakuzave dhe kërcënimet ndaj gazetarëve, sidomos atyre hulmues. Raportet e progresit për Kosovën rikujtojnë që liria e mediave garantohej me ligj dhe bëjnë thirrje për përpjekje më të mëdha në terren, siç janë hetimi dhe ndjekja penale e sulmeve fizike ndaj gazetarëve, si dhe për ndryshimin e dispozitave të Kodit Penal në lidhje me përgjegjësinë penale të mediave dhe mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës (IAPK) u ka bërë gjithashtu thirrje institucioneve që të mundësojnë qasje më të mirë në dokumente zyrtare, të sigurojnë financim adekuat për RTK-në dhe KPM-në për t'ua bërë të mundur funksionimin efektiv, apo të adresojnë çështjen e dispozitave të diskutueshme përkitazi me shpifjen civile dhe lirinë e medias në kuadrin përkatës ligjor. Vlen të ceket që në shkurt të vitit 2013 OSBE-ja ka përkrahur dëgjimin publik të Komisionit Parlamentar për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për të diskutuar rekomandimet e raportit të Avokatit të Popullit. Ky raport kishte identifikuar mungesën e komunikimit midis përfaqësuesve të mediave dhe Avokatit të Popullit si një ndër sfidat kryesore, përveç ankesave të gazetarëve të ndryshëm për sulme, kërcënime dhe frikësime ndaj tyre.

OSBE vazhdon po ashtu të angazhohet aktivisht në përmirësimin e gjendjes së lirisë së shprehjes dhe të medias në Kosovë. OSBE-ja vazhdon të përqendrohet në zhvillimin e shtypit dhe transmetuesve lokalë. Veç kësaj, OSBE ka qenë aktive në avokimin për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve, duke kërkuar që të ndërmerren masa kundër kërcënimeve, si dhe në dhënien e kontributit për ngritjen e mekanizmave efektivë të mbrojtjes ligjore në lidhje me lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve.

## **2.1. Frikësimet, kërcënimet dhe ushtrimi i dhunës ndaj gazetarëve**

Frikësimet, kërcënimet dhe ushtrimi i dhunës ndaj gazetarëve, si dhe ndjekja e pamjaftueshme e kryerësve vazhdojnë të përbëjnë sfida serioze përballë lirisë së medias në Kosovë. Në vitin 2011, AGPK raportoi 27 raste të sulmeve ndaj gazetarëve, nga të cilat 7 ishin kërcënime dhe 9 sish ishin sulme të dhunshme, për asnjërin prej të cilëve nuk ishte bërë ndjekje, ndërsa, në vitin 2012, i njëjti raportoi 24 raste, nga të cilat 10 kërcënime dhe pesë sulme të dhunshme.<sup>28</sup>

---

<sup>27</sup> Komisioni Evropian, Raportet e progresit për Kosovën, Bruksel (2009-2013).

<sup>28</sup> Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, Statistika të pengimit të punës së gazetarëve (2011 dhe 2012).

AGPK ka reagu duke dënuar publikisht pengimet në punën e gazetarëve në 32 raste në vitin 2010, në 27 raste në vitin 2011, dhe në 25 sish në vitin 2012.<sup>29</sup> Policia dhe gjyqësori në Kosovë i kategorizojnë ato vetëm si pjesë e numrit të gjithmbarshëm të rasteve të frikësimit, pa pasur mundësi t'i diferencojnë në bazë të natyrës së veprës si, për shembull, sulm fizik ndaj gazetarit, personit fizik apo kërcënim i cilitdo.<sup>30</sup> Megjithatë, AGPK vë në dukje që, përkundër rënies së numrit të përgjithshëm të rasteve të raportuara, rastet e regjistruara në vitin 2011 tregojnë një rritje të numrit të sulmeve fizike.<sup>31</sup> Të dhënat për rastet e pengimit të punës së mediave që i ka në dispozicion AGPK janë sporadike dhe ndryshueshme nga viti në vit për nga metodologjia e mbledhjes dhe kategorizimit të tyre, andaj nuk është e mundur të bëhet krahasim kuptimplotë përgjatë viteve.<sup>32</sup> Nga ana tjetër, AGPK ka regjistruar rastet e sulmeve ndaj gazetarëve nga ana e policisë gjatë ngjarjeve publike.

Statistikat zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) tregojnë që gjatë tre vjetëve të fundit nuk ka pasur ndonjë ndryshim domethënës në numrin e rasteve të përgjithshme të frikësimeve të individëve që janë ndjekur penalisht, dhe ky numër sillet në rreth 1,300 raste në vit. Mirëpo, prokurorët pohojnë që, ndonëse ligji nuk bën dallim midis gazetarëve dhe personave të tjerë, gazetarët që bien pre e kërcënimeve do të kenë trajtim preferencial.<sup>33</sup> Sipas prokurorisë, për shkak të natyrës së veçantë që ka puna e tyre, rasteve që përfshijnë gazetarë u jepet përparësi e njëllotjtë sikurse kërcënimeve ndaj personave zyrtarë në detyrë.<sup>34</sup> Ndonëse gazetarët e pranojnë që prokuroria bën ndjekjen e rasteve të dhunës dhe frikësimit, perceptimi i tyre është që zyrtarët policorë dhe prokurorial u kërkojnë që t'i raportojnë kërcënimet si kërcënime individuale, e jo si profesionale.<sup>35</sup> Përveç kësaj, nuk ka statistika profesionale për efikasitetin e ndjekjes penale të rasteve të dhunës ose frikësimit të gazetarëve.

## 2.2. Trysnia financiare mbi mediat dhe gazetarët

Derisa kërcënimet dhe frikësimet vazhdojnë të përbëjnë problem serioz, profesionistët e mediave përballen edhe me trysni financiare, si të drejtpërdrejtë ashtu edhe të tërthortë.<sup>36</sup> Dy forma të trysnisë së tërthortë, që përdoren për të ushtruar kontroll mbi mediat, janë reklamat dhe fondet nga qeveria.<sup>37</sup> Mungesa e rejtingjeve të qëndrueshme, të pavarura dhe të besueshme të

---

<sup>29</sup> Raporti i AGPK për periudhën janar-dhjetor 2012 përmban edhe një përmbledhje të rasteve ndaj të cilave ka reagu organizata, si dhe të kërcënimeve më të cilat përballen gazetarët sipas informatave të tyre.

<sup>30</sup> Policia e Kosovës, Raport vjetor 2012, Prishtinë/Priština 2012, f.11.

<sup>31</sup> Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar, "Dokument veprimi i gazetarëve profesionalë të Kosovës", (Prishtinë/Priština, 29 mars 2013). [http://www.apjk.org/repository/docs/Action\\_Papers%20Ang.pdf](http://www.apjk.org/repository/docs/Action_Papers%20Ang.pdf) (qasur më 27 nëntor 2013).

<sup>32</sup> Brahim Sadriu, zyrtar për informim, Policia e Kosovës, intervistë individuale, Prishtinë/Priština, korrik 2013

<sup>33</sup> Imer Beka, Kryeprokuror, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Priština, intervistë individuale, Prishtinë/Priština, korrik 2013

<sup>34</sup> *Po aty*; Hamdi Ibrahim, kryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Priština, intervistë individuale, Prishtinë/Priština, korrik 2013

<sup>35</sup> Perceptimi i lirisë së shprehjes dhe mediave nga gazetarët (20 gusht 2013), Prishtinë/Priština. pjesëmarrësit: anonimë [grup fokusi]

<sup>36</sup> Gazetar anonim, intervistë individuale. Prishtinë/Priština, korrik 2013.

<sup>37</sup> IREX. "Indeksi i qëndrueshmërisë së medias 2013". Uashington, 2013. f. 75, <http://www.irex.org/sites/default/files/u115/Europe%20%26%20Eurasia%20MSI%202013.pdf>; OSBE. "Tirazhi dhe politizimi i mediave të shkruara në Kosovë", Prishtinë/Priština, 2010, <http://www.osce.org/kosovo/67790>

shikueshmërisë dhe e të dhënave rreth tirazhit të shtypit shkaktojnë probleme si për reklamuesit ashtu edhe për producentët e mediave. Këto tri mjete, që janë vendimtare për vendimmarrjen nga mediat në gjithë tregjet e zhvilluara, nuk janë në dispozicion në Kosovë. Në mungesë të këtyre të dhënave, reklamuesit nuk kanë asnjë mënyrë logjike për të përzgjedhur për reklamim mediat që kanë ndonjë audiencë të veçantë, duke rezultuar në kthim të vogël për investimet e tyre dhe motivim të ulët për reklamim të qëndrueshëm. Në anën tjetër, mediat nuk janë edhe aq efikase në përmbajtjen që u ofrojnë shikuesve të tyre dhe, kështu, nuk po e arrijnë potencialin e tyre fitimprurës, si dhe nuk i shfrytëzojnë mundësitë për uljen e indiferencës dhe pakënaqësisë së konsumatorëve. Ky mjedis ua bën të mundur institucioneve publike që edhe ato pak fonde për reklama që i kanë në dispozicion t'i shfrytëzojnë për t'i favorizuar mediat që kanë qëndrim më miqësor ndaj tyre. Përveç kësaj, reklamuesve u ofrohet shumë pak, në mos fare hiq, nxitje për të zgjedhur një media në bazë të profesionalizmit dhe shikuesve të tyre.

Kur përballen me kërcënime e frikësim, gazetarëve iu mungojnë alternativat ndaj nënshtrimit ndaj presionit. Kjo kryesisht ndodh për shkak të jostabilitetit të madh të vendeve të punës, që përfshin oraret e gjata të punës, pagat e ulëta e të pasigurta, si dhe mungesën e trajnimeve e kontratave të punës. Të gjithë përveç dy gazetarëve të intervistuar në fokus-grupin e tetë gazetarëve thanë që kishin përjetuar kërcënime dhe frikësim nga zyrtarët publikë dhe/ose bizneset private. Këto presione sipas raportimeve vijnë në formën e telefonatave, emailave, si dhe komunikimeve personale, si para botimit të informatës, duke u munduar ta frenojnë, ashtu edhe pas publikimit, në përpjekje për të penguar publikimet tjera. Dy gazetarët që nuk kishin përjetuar presione në pozitat aktuale janë të punësuar në organizata ndërkombëtare mediale, por që të dy thoshin që kanë përjetuar frikësim më herët në karrierat e tyre, derisa punonin për media lokale në Kosovë. Ata gjithashtu ishin plotësisht të vetëdijshëm për presionet me të cilat përballen kolegët e tyre.

Shembuj të këtyre presioneve janë edhe telefonatat nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që shprehin pakënaqësitë e tyre ndaj një artikulli të botuar<sup>38</sup>; dekani i universitetit që viziton të përditshmen *Koha Ditore* për të bërë me zë kërcënime dhune ndaj personelit, në reagim të një reportazhi që ata e kishin botuar, duke mos u përballur me kurrfarë pasoje apo suspendimi nga pozita e tij udhëheqëse në universitet si rezultat i kësaj<sup>39</sup>; kërcënime të drejtpërdrejta përmes telefonit dhe postës elektronike për gazetarët dhe familjet e tyre, nganjëherë edhe të cekura me emër; kërcënime nga bizneset duke thënë që do të tërheqin reklamat nëse vazhdon raportimi i caktuar, si dhe situata në të cilat bizneset në fakt edhe ndalojnë reklamimin si reagim ndaj reportazheve të caktuara.<sup>40</sup>

Institucionet e Kosovës po ndërmarrin pak veprime për t'i adresuar këto sfida ndaj lirisë së medias. Si rezultat, mjedisi në të cilin gazetarët kanë pak alternativa ndaj dorëzimit ndaj presioneve politike apo ekonomike, ofron stimuj për ata që kanë pasuri e pushtet për të vazhduar këtë praktikë, duke nxitur më tutje ciklin e pushtetit dhe kontrollit mbi mediat. Jostabiliteti i vendit të punës dhe pagat e ulëta krijojnë një mjedis në të cilin shumë gazetarë mund të ndjehen,

---

<sup>38</sup> Ibid.

<sup>39</sup> Agron Bajrami, kryeredaktor, *Koha Ditore*, intervistë personale, Prishtinë/Priština, korrik 2013

<sup>40</sup> Arbana Xharra, redaktore, *Zëri*, intervistë personale, Prishtinë/Priština, korrik 2013

me të drejtë apo jo, që zbulimi i një storieje, ruajtja e vendit të punës, si dhe marrja e pagës është me më rëndësi sesa integriteti i raportimit apo forca e raportimit etik.<sup>41</sup> Gati çdo profesionist i mediave i intervistuar citonte standarde të dobëta të zbatimit të ligjit të punës brenda industrisë së mediave, si një prej shkaqeve kryesore të sfidave me të cilat gazetarët përballen në Kosovë. Përveç kësaj, profesionistët e lartpërmendur të mediave gjithashtu pajtohen njëzëri që standardet tejet të ulëta të profesionalizmit gjithashtu ndikojnë tek mediat në Kosovë. Standardi i ulët i profesionalizmit ndërmjet gazetarëve është rezultat i trajnimit të dobët, arsimimit të dobët, si dhe stimujve të dobët për t'u zhvilluar dhe për të prodhuar në cilësi më të lartë. Kjo ndikon tek besueshmëria, e si pasojë edhe tek lexueshmëria, financat, si dhe niveli i konkurrencës për vende pune në këtë industri. Një publikim që nuk ka standarde profesionale dhe të gjitha dobitë që e përcjellin, ka shumë gjasë të ketë më pak ndikim në krijimin e një mjedisi ku gazetarët mund të zhvillohen dhe lulëzojnë, apo ndonjë mjedis ku ligjet e punës zbatohen në mënyrë të mirëfilltë.

Territori dhe popullsia e vogël e Kosovës, bashkë me përqindjen e lartë të punëtorëve publikë, krijojnë një komunitet të vogël të punëtorëve që lidhen me një punëdhënës – qeverinë – për të krijuar jetesën. Në këtë mjedis, frikësimi politik mund të mbijetojë.<sup>42</sup> Në komunitete të integruara ngushtë, ku punësimi qeveritar prek aq shumë familje, secili politikan i fuqishëm, apo ndonjë biznesmen i lidhur me një parti politike, e ka pushtetin ta kërcënojë gazetarin jo vetëm në bazë të punës së atij gazetari, por edhe në bazë të punësimit të anëtarëve të familjes. Së paku një prej gazetarëve të intervistuar citonte një rast konkret, në të cilin një anëtar i familjes ishte kërcënuar nga administrata komunale – shënjestër e raportimeve të hulumtuara – me revokim të lejes së ndërtimit për një shtëpi ku ky gazetar as nuk planifikonte të jetonte.<sup>43</sup>

### **2.3. Ndikimi i biznesit privat tek gazetarët**

Ekonomia në Kosovë është zhvilluar në mënyrë disproporcionale, ku disa sektorë janë rritur shumë më shumë sesa tjerët. Sistemi bankar dhe telekomunikacioni janë në maje të listës. Për shkak të natyrës së këtyre bizneseve si dhe konkurrencës agresive në secilin prej këtyre dy sektorëve, është shumë e natyrshme që ato të bazohen shumë tek reklamimi për të ruajtur dhe zgjeruar bazën e tyre të konsumatorëve. Si rezultat, dy sektorët janë reklamuesit më të mëdhenj në sektorin privat. Bankat në veçanti dhe kompanitë e telekomunikacionit në masë të madhe rrallë i nënshtrohen kritikave në media. Një prej zyrtarëve të lartë ekzekutivë në një bankë të madhe që vepron në nivel ndërkombëtar përshkruante strategjinë e thjeshtë e cila u vërtetua si e suksesshme pas shpenzimit të kohës dhe parave në përpjekje tradicionale të marrëdhënies me publikun: banka thjesht e rrit hapësirën reklamuese në një medium të caktuar në një kohë të caktuar, duke bërë rotacionin me kujdes ashtu që të gjithë të mbesin të kënaqur.

Reklamimi është gjithsesi mjet i fuqishëm për të mbajtur mediat larg, por nuk është vërtetuar të jetë aq i fuqishëm për së paku një kompani. Rasti i operatorit kabllor IPKO kundër grupit KOHA ka ngritur çështjet e etikës, presioneve dhe legjislacionit të mangët. Konflikti ndërmjet dy

---

<sup>41</sup> Perceptimi i gazetarëve për lirinë e shprehjes dhe mediave (20 gusht 2013), Prishtinë/Priština. Pjesëmarrës: anonimë [grup fokusi]

<sup>42</sup> Agron Bajrami, kryeredaktor, *Koha Ditore*, intervistë personale, Prishtinë/Priština, korrik 2013; Besa Luci, kryeredaktore, *Kosova 2.0*, intervistë personale, Prishtinë/Priština, korrik 2013

<sup>43</sup> Gazetar anonim, intervistë personale, Prishtinë/Priština, korrik 2013

kompanive kishte filluar jashtë vëmendjes publike, derisa po negocionin kushtet e tarifës së ri-transmetimit për stacionin televiziv KTV, pronë e grupit KOHA. Mbas asaj që qartazi ishte dështim i negociatave, dy kompanitë filluan fushatat e njolloshjes kundër njëra-tjetrës, ku IPKO akuzonte grupin KOHA për zhvatje. Si reagim, KOHA publikoi storie për hetimin e kompanisë amë të IPKO-s në Slloveni, në lidhje me blerjen e IPKO-s më 2007. Konflikti përshkallëzoi kur IPKO vendosi të ndërrojë vendin e KTV-së nga kanali 3 në kanalën 83, në një platformë që nuk i mundëson shfrytëzuesit të ndryshojë listën dhe numrat e kanaleve televizive.<sup>44</sup> Shoqatat e mediave reagueshan ndaj kësaj mosmarrëveshjeje, duke mos marrë anë, por kryesisht duke insistuar që renditja duhet rregulluar nga KPM-ja, si dhe të mos i lihet në liri të veprimit operatorëve kabllorë.<sup>45</sup> Megjithatë, renditja e kanaleve televizive në sistemin kabllor nuk rregullohet nga KPM-ja. KTV-ja ende renditet në kanalën 83, si dhe nuk ka pasur raporte të tjera në lidhje me kompaninë sllovene amë të IPKO-s.

Këto ngjarje shkaktohen pjesërisht nga problemi bazë i mungesës së tregut të madh të reklamave. Një treg i tillë i vogël i reklamimit i detyron mediat të konkurrojnë për pak reklamues të mëdhenj, si operatorët e telekomit, që në disa raste kanë të drejta ri-transmetimi kabllor për operatorët televizivë. Si rezultat, reklamuesit janë në pozitë të ushtrimit të presionit mbi mediat, si dhe në rast të reklamuesve të mëdhenj me të drejta të ritransmetimit, ky presion është i dyfishtë, në kuptimin që mund t'i ndërpresin të ardhurat dhe të ndikojnë arritjen e mediave tek audienca e tyre. Për ta rënduar edhe më tepër problemin, gjyqësori i mbingarkuar nuk ka gjasë të zgjidhë shpejt rastet gjyqësore ndërmjet bizneseve. Kjo është ngarkesë për mediat, sepse kapacitetet e tyre financiare e bëjnë gati të paarrtshme për ta që të ndjekin rastet gjyqësore që mund të zgjaten me vite. Përfundimisht, mungesa e kornizës adekuate ligjore që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e transmetuesve dhe operatorëve kabllorë, por edhe të rishitësve, i vë mediat në pozitë edhe më të pafavorshme në krahasim me bizneset tjera. Si rezultat, krijimi i kornizës adekuate legjislative dhe mekanizmave efikas të përmbartimit të obligimeve kontraktuale janë veprime qenësore.

---

<sup>44</sup> Donjetë Hoxha, “KPM: Ipko Shkelje me KTV-në,” *Gazeta JNK*, 12 prill 2013 - <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,5284>

<sup>45</sup> Ibid.



## PËRFUNDIME

Tema e lirisë së mediave në Kosovë vazhdon të jetë burim i debatit publik. Përkundër gatishmërisë së deklaruar të institucioneve publike për t'u përballur me sfidat në lidhje me lirinë e mediave të identifikuar në këtë raport, demonstruar më së miri nga zelli i miratimit të ligjeve të reja, gazetarët vazhdojnë të jenë të kërcënuar. Derisa grupet e fokusit tregojnë që gazetarët ndjejnë të njëjtën siguri si personat tjerë në profesione tjera, sulmet që lindin si rezultat i kryerjes së profesionit të tyre vazhdojnë të ndodhin.

Megjithatë, përfaqësuesit e sektorit të sundimit të ligjit, si policia dhe prokuroria, theksojnë që ata i ndjekin në mënyrë aktive rastet e dhunës kundër gazetarëve. Megjithatë, të dhënat për vërtetimin e këtyre deklaratave nuk mund të gjenden. Në anën tjetër, korniza ligjore e rregullative relativisht e re tregon që prokurorët e gjyqtarët nuk kanë arritur ende të zhvillojnë kapacitetet dhe t'i kuptojnë plotësisht këto korniza, ashtu që t'i zbatojnë ato plotësisht.

Problemi me aftësinë e gjyqtarëve e prokurorëve për zbatim të ligjeve të mediave është i të njëjtës masë në gjithë spektrin e institucioneve publike, duke marrë parasysh që zbatimi i legjislacionit të ndërlidhur me mediat është i pamjaftueshëm. Sfida më e madhe qëndron tek Ligji për qasje në dokumente publike, ku gazetarët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile së bashku e theksojnë mungesën e zbatimit të tij.<sup>46</sup> Pra, është shumë e qartë që thjesht ekzistenca e ligjit nuk kontribuon në ndonjë përmirësim të vërtetë në praktikë.

Mediat dhe gazetarët, si pasojë, mbeten në pozitë mjaft të pafavorshme financiare në krahasim me atë që do të ishte optimale për të siguruar një mjedis profesional pune dhe gazetari të pavarur e profesionale. Me një treg të vogël reklamash dhe pa matje të audiencës nga mediat, të ardhurat mbeten të kufizuara. Përveç këtyre, të ardhurat nga reklamimi prej institucioneve publike vazhdimisht përmenden si vegël për të favorizuar mediat miqësore ndaj qeverisë. Kjo mungesë e përgjithshme e të ardhurave ndikon tek pronarët e mediave, ku pastaj pagat fillestare të gazetarëve të rinj mbesin shumë nën mesatare, derisa mundësitë e avancimit në karrierë shumë të vogla. Këto, bashkë me mungesën e mundësive të karrierës, sektorëve të tjerë publikë apo privatë që paguajnë më mirë, si dhe pa stimulime për besnikëri ndaj punëdhënësve, e bëjnë shkallën e qarkullimit të gazetarëve tejet të lartë.<sup>47</sup> Ky ndërrim i vendeve të punës vlen si përbrenda sektorit të mediave, ashtu edhe për zhvendosjen e gazetarëve nga sektori i mediave në fusha të tjera.

Përveç këtyre, gazetaria në Kosovë ende mbetet e nënshtruar ndaj kërcënimeve dhe dhunës. Përkundër zvogëlimit të rasteve të raportuara të kërcënimeve dhe dhunës nga gazetarët apo shoqatat e gazetarëve, këto probleme vazhdojnë të qëndrojnë. Në anën tjetër, gjyqësori ende mbetet prapa me kapacitete për zbatimin e ligjeve për media dhe legjislacionit për mbrojtje të

---

<sup>46</sup> Ligji për qasje në dokumente zyrtare nuk respektohet, Koha.net 21-07-2011, <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,63363>; Dokumentet publike pak të qasshme <http://gazetajnk.com/?cid=1%2C3%2C4516>

<sup>47</sup> Perceptimi i gazetarëve për lirinë e shprehjes dhe mediave (20 gusht 2013), Prishtinë/Priština. Pjesëmarrës: anonim [Grup fokus]

gazetarëve. Si rezultat, ndjekja e rasteve të kërcënimit dhe frikësimit ndaj gazetarëve mbetet e vogël, duke lënë hapësirë për më shumë presion ndaj gazetarëve. Tregu i vogël i reklamave dhe kapacitetet e kufizuara të mediave private gjithashtu ndikojnë në punën e atyre mediave. Derisa reklamuesit e mëdhenj janë të pakët në Kosovë, pronarët e bizneseve me tregun më të madh të reklamimit janë në pozitë të ushtrojnë presion mbi mediat, duke kufizuar buxhetin reklamues për atë medium. Kjo depërton përtej barrierës ndërmjet bizneseve dhe redaktorëve, e cila është e domosdoshme në media të lajmeve, e rrjedhimisht ndikon edhe tek liria e medias në Kosovë.

Si rrjedhojë, profesionalizmi në sferën e mediave në Kosovë vuan në masë të konsiderueshme, me stimuj të pakët për profesionistët për zhvillimin e një karriere në gazetari. Kjo nuk ndihmohet fare as nga mungesa e përgjithshme e kapaciteteve të KPM-së dhe KMSHK-së për rregullim dhe vetë-rregullim të vazhdueshëm dhe të kujdesshëm të sferës së mediave në Kosovë, duke i mundësuar gazetarisë jociësore dhe të pasaktë të vazhdojë të ekzistojë. Përkundër këtyre, disa media vazhdojnë të ofrojnë storie të jashtëzakonshme gazetarie, duke treguar kështu që brenda sektorit të mediave ende ekziston vullneti për të zhvilluar gazetari cilësore. Ky vullnet duhet të ushqehet në vazhdimësi përmes mundësive të arsimimit e trajnimit profesional, si dhe me përkrahje adekuate nga trupat rregullues.

Edhe pse përgjithësisht mediat në Kosovë kanë mbijetuar në dekadën e fundit përkundër kushteve ekonomike, liria e medias është ende në rrezik, ku mediat dhe gazetarët përballen me sfida të sistemit. Bashkimi i interesave politikë e afaristë kundrejt mediave apolitike në masë të madhe ndikon tek kapaciteti i gazetarëve për të punuar vërtetë në mënyrë të pavarur, duke nxitur vetë-censurimin dhe duke detyruar të gjitha mediat që të për afrohen me një interes apo një tjetër. Luftimi i këtij fenomeni do të kërkojë përpjekje strategjike nga mediat dhe përkrahësit e tyre drejt zhvillimit të kapaciteteve, si dhe së paku drejt shtyrjes së gjyqësorit dhe institucioneve tjera të sundimit të ligjit kah veprimet më efikase.

## **REKOMANDIME**

1. Pronarët dhe drejtuesit e mediave duhet të kërkojnë mundësi për të siguruar paga më adekuate, të ofrojnë beneficione dhe trajnim të vazhdueshëm të gazetarëve të tyre. Partneritetet me institucione arsimore, shkëmbime me media jofitimprurëse dhe/ose media publike ndërkombëtare, janë të preferueshme.
2. Pronarët dhe drejtuesit e mediave duhet ta përmirësojnë të kuptuarit e tyre të audiencës që e synojnë dhe interesave të saj, ashtu që të pasurojnë portofolin e mbulimit të tyre dhe të tërheqin më shumë reklamues.
3. KGJK-ja duhet të hartojë programe trajnimi për gjyqtarë e prokurorë në lidhje me legjislacionin e ri për media, praktikat më të mira dhe implementimin e tyre.
4. Programet profesionale të arsimimit juridik duhet të përmbajnë module që fokusohen në zbatimin e ligjeve në lidhje me mediat.

5. Qeveria duhet të fillojë shqyrtimin e çështjeve kryesore në lidhje me zbatimin e Ligjit për qasje në dokumente publike, si dhe të propozojë ose ndryshimin e ligjit, ose procedura për të përmirësuar zinxhirin e zbatimit të tij.

6. Organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë duhet të avokojnë dhe të bëjnë presion tek institucionet për të rritur ndjekjen e krimeve ndaj gazetarëve dhe lirisë së shprehjes. Përveç kësaj, institucionet lokale duhet të punojnë më ngushtë me mediat, për të siguruar përkrahje me kohë dhe të organizuar në rastet e dhunës, frikësimit apo kërcënimeve.

7. Shoqatat e gazetarëve duhet të fillojnë t'i përmbushin plotësisht detyrimet e tyre sipas statutit. Anëtarët e këtyre shoqatave duhet të kërkojnë llogaridhënie dhe transparencë nga personeli i zgjedhur, si dhe duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre për ta udhëhequr shoqatën në drejtimin e duhur, sipas nevojës.